



# UNIVERSITETI I SHKODRËS

## “Luigj Gurakuqi”

SENATI

Nr. 2884 prot.

Shkodër, më 15. 08. 2016

### V E N D I M

nr. 341, datë 15. 08. 2016

#### “ PËR MIRATIMIN E RREGULLOREVE PER KONKURSET E PRANIMIT”

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë” neni 38 pika 1 germa d, me propozim të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 15.08.2016;

#### V E N D O S I:

1. Miratimin e rregulloreve për konkurset e pranimit në programet e studimit (bashkëlidhur këtij vendimi )
  - Rregullore për konkursin e pranimit në programin e studimit Bachelor në Edukim fizik dhe Sporte
  - Rregullore për konkursin e pranimit në programin e studimit Bachelor në Pikturë dhe grafikë
  - Rregullore për konkursin e pranimit në programin e studimit Bachelor në Pedagogji Muzikore
2. Ngarkohen Zv.rektori, Dega e Kurrikulave dhe Kërkimit Shkencor Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Kryetari i Senatit Akademik

Prof.dr. Adem BEKTESHI



**UNIVERSITETI I SHKODRËS**

***“Luigj Gurakuqi”***

**Fakulteti i Shkencave të Edukimit**

**Departamenti i Arteve**

**RREGULLORE PËR KONKURIM**

**NË PROGRAMIN E STUDIMIT**

**PEDAGOGJI MUZIKORE**

**(Cikli i parë i studimeve)**



## Neni 1

### Dispozita të përgjithshme

1. Rregullorja e pranimit për konkurrim në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Pedagogji Muzikore, të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Departamenti i Arteve i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, mbështetet në:
  - a. Udhëzimin nr. 13, datë 22.07.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2016 – 2017”,
  - b. Statutin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
  - c. Rregulloren e studimeve të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

## Neni 2.

### Pranimi i kandidateve

- 2.1 Kanë të drejtë të konkurrojnë në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Pedagogji Muzikore, të gjithë ato kandidatë që kanë zgjedhur këtë program studimi dhe ndodhen në listat e pjesëmarrëse në konkursin e pranimit të dërguara nga AKP-ja.
- 2.2 Listat e konkurrentëve do të shpallen më datë 16.09.2016 në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe në faqen elektronike të Universitetit të Shkodrës.
- 2.3 Kandidati fiton të drejtën për të konkurruar në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Pedagogji Muzikore nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore të Fakultetit të Shkencave të Edukimit në datat 22.08.2016 deri 26.08.2016, nga ora 08:00 – 14:00.
- 2.4 Për regjistrim në konkurs kandidati dorëzon në sekretarinë mësimore këto dokumente:
  - a. Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumenteve të identifikimit.
  - b. Pagesën e tarifës me vlerë 5000 lekë, të miratuar nga Rektori, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në përmjet faturës së publikuar në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al).
  - c. 2 (dy) fotografi në përmasat 4 x 6.
- 2.5 Sekretaria mësimore pas regjistrimit të kandidatit e pajis me fletën e regjistrimit ku shënohet data e regjistrimit dhe dokumentet e dorëzuara.





2.6 Kandidati që nuk regjistrohet në datat e përmendura në pikën 2.3 humb të drejtën e pjesëmarrjes në konkurs.

### **Neni 3**

#### **Datat e zhvillimit të konkursit**

3.1 Datat e zhvillimit të konkurseve të pranimit në programet e studimit, cikli i parë i studimit (Bachelor), sistemi me kohë të plotë në Pedagogji Muzikore, do të jenë **29 dhe 30 Gusht 2016**.

3.2 Konkurrenti që nuk paraqitet në datat e konkursit të pranimit humb të drejtën për të vazhduar programin e studimit cikli i parë i studimit (Bachelor), sistemi me kohë të plotë në Pedagogji Muzikore.

### **Neni 4.**

#### **Programi i konkurrimit**

4.1 Programi i konkursit për pranimin në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Pedagogji Muzikore, hartohet nga Departamenti i Arteve dhe miratohet nga Senati i USH.

4.2 Konkurruesit kanë të drejtën paraprake të njihen me programin e konkursit i cili bëhet publik duke e shpallur në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

4.3 Pranimet në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Pedagogji Muzikore, viti akademik 2016 – 2017, bëhen mbi bazën rezultateve të Maturës Shtetërore dhe të rezultateve të fituara nga konkursi i pranimit, si:

- a. **Matura shtetërore 30%**, nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimin e Maturës Shtetërore.
- b. **Konkursi i pranimit 70%**.

### **Neni 5**

#### **Komisioni i konkursit**

5.1 Drejtori i Departamentit të Arteve propozon listën e anëtarëve të stafit akademik për komisionin e konkursit të pranimit, e cila miratohet nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Nga kjo listë Rektori emëron komisionin e konkursit.

5.2 Komisioni shpallet ditën e konkurrimit.

5.3 Konkursi organizohet nga Departamenti i Arteve dhe monitorohet nga Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Rektorati.



## Neni 6.

### Përgatitja e konkursit

6.1 Sekretaria mësimore (SM) përgatit listat dhe pajis çdo konkurrent me kartelën personale të rezultateve të konkursit.

6.2 Konkurruesit duhet të paraqiten pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimi më datë 29.08.2016, në ora 8<sup>00</sup>. Drejtori i Departamentit i njih konkurrentet me rregullat e organizimit të konkursit. Zbatimi me korrektësi i rregullave të konkursit është i detyrueshëm për çdo konkurrent.

## Neni 7

### Zhvillimi i konkursit

7.1 Konkurrimi zhvillohet sipas renditjes në listat e shpallura nga sekretaria mësimore. Askush nuk ka të drejtë të ndryshojë renditjen e konkurrentëve në konkurs.

7.2 Zhvillimi i konkursit bëhet sipas programit të përgatitur dhe të bërë publik nga Departamenti i Arteve të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, që është afishuar në faqen elektronike të Universitetit [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al).

7.3 Në ambientet e konkurrimit nuk lejohen të hyjnë persona të tjerë me përjashtim të konkurruesve, komisionit dhe personat e ngarkuar nga Dekanati dhe Rektorati.

7.4 Konkursi do të zhvillohet në tre faza si më poshtë:

- a. Faza e parë e konkursit: Provim me shkrim në Solfezh dhe në Harmoni.
- b. Faza e dytë e konkursit: Provim për formimin e përgjithshëm muzikor,
- c. Faza e tretë e konkursit: Konkurrentët do të luajnë një pjesë me përzgjedhje të lirë në një instrument muzikor (me parapëlqim pianoforten).

*(Shih kriteret e pranimit në programin e studimit të Pedagogji Muzikore shpallur në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al)).*

7.5 Pikët e konkursit ndahen si më poshtë:

- |   |          |
|---|----------|
| a. Faza I: 21% shkrim në Solfezh dhe në Harmoni     | 63 pikë  |
| b. Faza e II: 60% formimi i përgjithshëm muzikor    | 126 pikë |
| c. Faza III: 10% interpretimi në instrument muzikor | 21 pikë  |

**Gjithsej**

**210 pikë**





## Neni 8

### Shpallja e rezultateve

- 8.1 Konkurruesi njihet menjëherë nga komisioni me rezultatet e disiplinës ku konkurren pas realizimit të testit përkatës. Rezultati i komunikuar shënohet (me bojë) menjëherë në kartelën e rezultateve personale të konkurruesit, e cila firmoset nga studenti dhe kryetari i komisionit.
- 8.2 Konkurruesi ka të drejtë të ankohet për vlerësimin tek Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit, brenda ditës së komunikimit të rezultatit. Ankimi shqyrtohet nga Dekanati i Fakultetit brenda një dite nga paraqitja e tij. Vendimi i Dekanatit është i formës së prerë.
- 8.3 Brenda datës 04.09.2016 sekretaria mësimore hedh në sistemin informatik pikët e secilit kandidat në konkurrim.
- 8.4 Pas llogaritjes së pikëve për çdo konkurrent, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga USH, hartohen listat e konkurrentëve të renditura sipas pikëve të grumbulluara në sensin zbritës, ku fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin e studimit në fjalë.
- 8.5 Listat afishohen brenda datës 05.09.2016 në Fakultetin e Shkencave të Edukimit dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Një kopje e kësaj liste me datën 06.09.2016 i përcillet AKP-së nga sekretaria mësimore.

## Neni 9

### Dispozita të fundit

- 9.1 Kjo rregullore e shtrin veprimtarinë, duke filluar nga viti akademik 2016 – 2017.
- 9.2 Të drejtën për interpretimin e kësaj Rregulloreje e ka Rektorati i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

**Kryetari i Senatit Akademik**

**Prof.dr. Adem BEKTESHI**





**UNIVERSITETI I SHKODRËS**

*“Luigj Gurakuqi”*

**Fakulteti i Shkencave të Edukimit**

**RREGULLORE PËR KONKURIM**

**NË PROGRAMIN E STUDIMIT**

**PIKTURË - GRAFIKË**

**(Cikli i parë i studimeve)**





## Neni 1

### Dispozita të përgjithshme

1. Rregullorja e pranimit për konkurrim në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Pikturë - Grafikë, të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Departamenti i Arteve i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, mbështetet në
  - a. Udhëzimin nr. 13, datë 22.07.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2016 – 2017”,
  - b. Statutin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
  - c. Rregulloren e studimeve të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

## Neni 2.

### Pranimi i kandidateve

- 2.1 Kanë të drejtë të kandidojnë në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Pikturë - Grafikë, të gjithë ato kandidatë që kanë zgjedhur këtë program studimi dhe ndodhen në listat e pjesëmarrëse në konkursin e pranimit të dërguara nga AKP-ja.
- 2.2 Listat e konkurrentëve do të shpallen më datë 16.09.2016 në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe në faqen elektronike të Universitetit të Shkodrës.
- 2.3 Kandidati fiton të drejtën për të konkurruar në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Pikturë - Grafikë nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore të Fakultetit të Shkencave të Edukimit në datat 22.08.2016 deri 26.08.2016, nga ora 08<sup>00</sup>-14<sup>00</sup>.
- 2.4 Për regjistrim në konkurs kandidati dorëzon në sekretarinë mësimore këto dokumente:
  - a. Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumenteve të identifikimit.
  - b. Pagesën e tarifës me vlerë 5000 lekë, të miratuar nga Rektorati, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në përmjet faturës së publikuar në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
  - c. 2 (dy) fotografi në përmasat 4 x 6.
- 2.5 Sekretaria mësimore pas regjistrimit të kandidatit e pajis me fletën e regjistrimit ku shënohet data e regjistrimit dhe dokumentet e dorëzuara.





2.6 Kandidati që nuk regjistrohet në datat e përmendura në pikën 2.3 humb të drejtën e pjesëmarrjes në konkurs.

### Neni 3

#### Datat e zhvillimit të konkursit

3.1 Datat e zhvillimit të konkurseve të pranimit në programet e studimit, cikli i parë i studimit (Bachelor), sistemi me kohë të plotë në Pikturë - Grafikë, do të jenë **29 dhe 30 Gusht 2016**.

3.2 Konkurrenti që nuk paraqitet në datat e konkursit të pranimit humb të drejtën për të vazhduar programin e studimit cikli i parë i studimit (Bachelor), sistemi me kohë të plotë në Pikturë – Grafikë.

### Neni 4.

#### Programi i konkurrimit

4.1 Programi i konkursit për pranimin në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Pikturë - Grafikë, hartohet nga Departamenti i Arteve dhe miratohet nga Senati i USH.

4.2 Konkurruesit kanë të drejtën paraprake të njihen me programin e konkursit i cili bëhet publik duke e shpallur në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al).

4.3 Pranimet në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Pikturë - Grafikë, viti akademik 2016 – 2017, bëhen mbi bazën rezultateve të Maturës Shtetërore dhe të rezultateve të fituara nga konkursi i pranimit, si:

- a. Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimin e Maturës Shtetërore 30%.
- b. Konkursi i pranimit 70%.

### Neni 5

#### Komisioni i konkursit

5.1 Drejtori i Departamentit të Arteve propozon listën e anëtarëve të stafit akademik për komisionin e konkursit të pranimit, e cila miratohet nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Nga kjo listë Rektori emëron komisionin e konkursit.

5.2 Komisioni shpallet ditën e konkurrimit.



5.3 Konkursi organizohet nga Departamenti i Arteve dhe monitorohet nga Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Rektorati.

#### Neni 6.

##### Përgatitja e konkursit

6.1 Sekretaria mësimore (SM) përgatit listat dhe pajis çdo konkurrent me kartelën personale të rezultateve të konkursit.

6.2 Konkurruesit duhet të paraqiten pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit më datë 29.08.2016, në ora 8<sup>00</sup>. Drejtori i Departamentit i njeh konkurrentët me rregullat e organizimit të konkursit. Zbatimi me korrektësi i rregullave të konkursit është i detyrueshëm për çdo konkurrent.

#### Neni 7

##### Zhvillimi i konkursit

7.1 Konkurrimi zhvillohet sipas renditjes në listat e shpallura nga sekretaria mësimore. Askush nuk ka të drejtë të ndryshojë renditjen e konkurrentëve në konkurs.

7.2 Zhvillimi i konkursit bëhet sipas programit të përgatitur dhe të bërë publik nga Departamenti i Arteve të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, që është afishuar në faqen elektronike të Universitetit [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al).

7.3 Në ambientet e konkurrimit nuk lejohen të hyjnë persona të tjerë me përjashtim të konkurruesve, komisionit dhe personat e ngarkuar nga Dekanati dhe Rektorati.

7.4 Konkurrenti mban përgjegjësi për vërtetësinë e dosjes së vet. Nëse komisioni vërteton të kundërtën, konkurrenti humb të drejtën e pranimit për atë vit akademik.

7.5 Pikët e konkursit ndahen si më poshtë:

- |                                      |          |
|--------------------------------------|----------|
| a. 60% punimi i realizuar në konkurs | 180 pikë |
| b. 10% dosja e studentit             | 30 pikë  |

**Gjithsej 210 pikë**

(Shih kriteret e pranimit në programin e studimit të Pikturë-Grafikë shpallur në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al))







## Neni 8

### Shpallja e rezultateve

- 8.1 Konkurruesi njihet menjëherë nga komisioni me rezultatet e disiplinës ku konkurren pas realizimit të testit përkatës. Rezultati i komunikuar shënohet (me bojë) menjëherë në kartelën e rezultateve personale të konkurruesit, e cila firmoset nga studenti dhe kryetari i komisionit.
- 8.2 Konkurruesi ka të drejtë të ankohet për vlerësimin tek Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit, brenda ditës së komunikimit të rezultatit. Ankimi shqyrtohet nga Dekanati i Fakultetit brenda një dite nga paraqitja e tij. Vendimi i Dekanatis është i formës së prerë.
- 8.3 Brenda datës 04.09.2016 sekretaria mësimore hedh në sistemin informatik pikët e secilit kandidat në konkurrim.
- 8.4 Pas llogaritjes së pikëve për çdo konkurrent, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara nga USH, hartohen listat e konkurrentëve të renditura sipas pikëve të grumbulluara në sensin zbritës, ku fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin e studimit në fjalë.
- 8.5 Listat afishohen brenda datës 05.09.2016 në Fakultetin e Shkencave të Edukimit dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Një kopje e kësaj liste me datën 06.09.2016 i përcillet AKP-së nga sekretaria mësimore.

## Neni 9

### Dispozita të fundit

- 9.1 Kjo rregullore e shtrin veprimtarinë, duke filluar nga viti akademik 2016 – 2017.
- 9.2 Të drejtën për interpretimin e kësaj Rregulloreje e ka Rektorati i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

**Kryetari i Senatit Akademik**

Prof.dr. Adem BEKTESHI



**UNIVERSITETI I SHKODRËS**

***“LuigjGurakuqi”***

**Fakulteti i Shkencave të Edukimit**

**Departamenti i Edukimit Fizik e Sporteve**

**RREGULLORE PËR KONKURIM**

**NË PROGRAMIN E STUDIMIT**

**EDUKIM FIZIK E SPORTE**

**(Cikli parë i studimeve)**





## Neni 1

### Dispozita të përgjithshme

- 1.1 Rregullorja e pranimit për konkurrim në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Edukimin Fizik dhe Sporte, të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Departamenti i Arteve i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, mbështetet në:
- Udhëzimin nr. 13, datë 22.07.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2016 – 2017”,
  - Statutin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
  - Rregulloren e studimeve të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

## Neni 2.

### Pranimi i kandidateve

- 2.1 Kanë të drejtë të kandidojnë në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Edukimin Fizik dhe Sporte, të gjithë ato kandidatë që kanë zgjedhur këtë program studimi dhe ndodhen në listat e pjesëmarrëse në konkursin e pranimit të dërguara nga AKP-ja.
- 2.2 Listat e konkurrentëve do të shpallen më datë 16.09.2016 në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe në faqen elektronike të Universitetit të Shkodrës.
- 2.3 Kandidati fiton të drejtën për të konkurruar në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Edukimin Fizik dhe Sporte nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore të Fakultetit të Shkencave të Edukimit në datat 22.08.2016 deri 26.08.2016, nga ora 08<sup>00</sup>-14<sup>00</sup>.
- 2.4 Për regjistrim në konkurs kandidati dorëzon në sekretarinë mësimore këto dokumente:
- Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e një prej dokumenteve të identifikimit.
  - Pagesën e tarifës me vlerë 5000 lekë, të miratuar nga Rektori, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në përmjet faturës së publikuar në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
  - Raportin mjeko – ligjor
  - 2 (dy) fotografi në përmasat 4 x 6.
- 2.5 Sekretaria mësimore pas regjistrimit të kandidatit e pajis me fletën e regjistrimit ku shënohet data e regjistrimit dhe dokumentet e dorëzuara.

2.6 Kandidati që nuk regjistrohet në datat e përmendura në pikën 2.3 humb të drejtën e pjesëmarrjes në konkurs.

### Neni 3

#### Datat e zhvillimit të konkursit

3.1 Datat e zhvillimit të konkurseve të pranimit në programet e studimit, cikli i parë i studimit (Bachelor), sistemi me kohë të plotë në Edukimin Fizik dhe Sporte, do të jenë **29 dhe 30 Gusht 2016**.

3.2 Konkurrenti që nuk paraqitet në datat e konkursit të pranimit humb të drejtën për të vazhduar programin e studimit cikli i parë i studimit (Bachelor), sistemi me kohë të plotë në Edukimin Fizik dhe Sporte.

### Neni 4.

#### Programi i konkurrimit

4.1 Programi i konkursit për pranimin në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Edukimin Fizik dhe Sporte, hartohet nga Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve dhe miratohet nga Senati i USH.

4.2 Konkurruesit kanë të drejtën paraprake të njihen me programin e konkursit i cili bëhet publik duke e shpallur në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al)

4.3 Pranimet në programin e studimit të ciklit të parë (Bachelor) në Edukimin Fizik dhe Sporte, viti akademik 2016 – 2017, bëhen mbi bazën rezultateve të Maturës Shtetërore dhe të rezultateve të fituara nga konkursi i pranimit, si më poshtë:

- a. **Konkursi i pranimit 70%.**
- b. **15%** Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimet e Maturës Shtetërore
- c. **15%** Nota mesatare e lëndëve Edukim fizik, Biologji, Histori, Aftësim për jetën

### Neni 5

#### Komisioni i konkursit

5.1 Drejtori i Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve propozon listën e anëtarëve të stafik akademik për komisionin e konkursit të pranimit, e cila miratohet nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Nga kjo listë Rektori emëron komisionin e konkursit.

5.2 Komisioni shpallet ditën e konkurrimit.





5.3 Konkursi organizohet nga Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve dhe monitorohet nga Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Rektorati.

## Neni 6.

### Përgatitja e konkursit

6.1 Sekretaria mësimore (SM) përgatit listat dhe pajis çdo konkurrent me kartelën personale të rezultateve të konkursit.

6.2 Konkurruesit duhet të paraqiten pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit më datë 29.08.2016, në ora 8<sup>00</sup>. Drejtori i Departamentit i njeh konkurrentët me rregullat e organizimit të konkursit. Zbatimi me korrektësi i rregullave të konkursit është i detyrueshëm për çdo konkurrent.

## Neni 7

### Zhvillimi i konkursit

7.1 Konkurrimi zhvillohet sipas renditjes në listat e shpallura nga sekretaria mësimore. Askush nuk ka të drejtë të ndryshojë renditjen e konkurrentëve në konkurs.

7.2 Zhvillimi i konkursit bëhet sipas programit të përgatitur dhe të bërë publik nga Departamenti i Arteve të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, që është afishuar në faqen elektronike të Universitetit [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al).

7.3 Në ambientet e konkurrimit nuk lejohen të hyjnë persona të tjerë me përjashtim të konkurruesve, komisionit dhe personat e ngarkuar nga Dekanati dhe Rektorati.

7.4 Konkursi do të zhvillohet me dy teste si më poshtë:

- a. **Testi nr. 1** - Cirkuit me elemente përzgjedhura nga sportet: atletike, gjimnastike, futboll, volejboll dhe basketboll.
- b. **Testi nr. 2** - kërcim se gjati nga vendi meshkuj – femra.

*(Shih kriteret e pranimit në programin e studimit të Edukimit Fizik dhe Sporteve shpallur në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al)).*

7.5 Pikët e konkursit ndahen si më poshtë:

- |                          |         |
|--------------------------|---------|
| a. Testi nr. 1 maksimumi | 50 pikë |
| b. Testi Nr. 2 maksimumi | 20 pikë |

**Gjithsej. 70 pikë**

## Neni 8

### Shpallja e rezultateve

- 8.1 Konkurruesi njihet menjëherë nga komisioni me rezultatet e disiplinës ku konkurren pas realizimit të testit përkatës. Rezultati i komunikuar shënohet (me bojë) menjëherë në kartelën e rezultateve personale të konkurruesit, e cila firmoset nga studenti dhe kryetari i komisionit.
- 8.2 Konkurruesi ka të drejtë të ankohet për vlerësimin tek Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit, brenda ditës së komunikimit të rezultatit. Ankimi shqyrtohet nga Dekanati i Fakultetit brenda një dite nga paraqitja e tij. Vendimi i Dekanatit është i formës së prerë.
- 8.3 Brenda datës 04.09.2016 sekretaria mësimore hedh në sistemin informatik pikët e secilit kandidat në konkurrim.
- 8.4 Pas llogaritjes së pikëve për çdo konkurrent, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga USH, hartohen listat e konkurrentëve të renditura sipas pikëve të grumbulluara në sensin zbritës, ku fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin e studimit në fjalë.
- 8.5 Listat afishohen brenda datës 05.09.2016 në Fakultetin e Shkencave të Edukimit dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Një kopje e kësaj liste me datën 06.09.2016 i përcillet AKP-së nga sekretaria mësimore.

## Neni 9

### Dispozita të fundit

- 9.1 Kjo rregullore e shtrin veprimtarinë, duke filluar nga viti akademik 2016 – 2017.
- 9.2 Të drejtën për interpretimin e kësaj Rregulloreje e ka Rektorati i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

**Kryetari i Senatit Akademik**

Prof.dr. Adem BEKTESHI

